MBRETNIJA SHQIPTARE

MINISTRIJA E EKONOMISË KOMBËTARE

LIGJË E RREGULLORE

mbi

STATISTIKËN E GJENDJES S'EKONOMISË KOMBËTARE

BKSH

TIRANË
SHTYPSHKRONJA «TIRANA»
1931

KOMBETARE
BIBLIOTEKA
88
A
153
TIRANË

BKSH

LIGJË

MBI STATISTIKËN E GJENDJES S'EKONOMIS KOMBËTARE

Neni 1.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare për ç'do vjet do të pergatiti statistikën e degës së bujqësis, të veterinarisë, të pyjeve, të minjerave, të hidraulikës, të tregtis e t'industris, për të gjitha viset e Mbretnis.

Neni 2.

Autoritetet Administrative, të Bashkive, të Katundarive si edhe Odat e Ekonomis detyrohen me krye mbledhjen e landës të nevojëshme për përpilimin e Statistikës.

Neni 3.

Ç'do person Fizik ose moral është i detyruem me u përgjegjë plotësisht pyetjeve qe do t'u drejtohen nga personali kompetent si mbas pasqyrzave të pregatituna prej Seksionit të Statistikës, në mbështetje të nenit 34 të Ligjes organike të Ministris s'Ekonomis Kombëtare.

Neni 4.

Ç'do pakujdesi ose kundravajtje qe i bahet nenit 2 të kësaj Ligje, prej personalit t'autoriteteve përkatëse, ndeshkohet si mbas ligjeve në fuqi.

Kundravajtësit e nenit 3, dënohen si mbas dispozitave të Kodit Penal, prej gjykatoreve kompetente.

Neni 5.

Dënimet e përmenduna në paragrafin e dyt të nenit të ma sipërm, vendosen prej gjykatores kompetente të qarkut përkatës në bazë të Proces verbalit të bamë prej përsonës s'autorizueme për zbatimin e dispozitës së fyeme të kësaj Ligje.

Neni 6.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare do të përgatit Rregulloren e posaçme për zbatimin e kësaj Ligje.

Neni 7.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare, Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Drejtësis, ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Neni 8.

Kjo Ligj hyn në fuqi në krye të 15 ditëve mbas shpalljes saj në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarëve

D e k r e t o n

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjes mbi Statistikën e gjendjes s'Ekonomis Kombëtare, i votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 607-I datë 3-IV-1930 të Kryesis së tij.

Tiranë, me 8 Prill 1930.

Z O G d. v.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli d. v.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami d. v.

Zav. Ministri P. Mbrendshem
R. Fico d. v.

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frashëri d. v.

Regullore

mbi aplikimin e Ligjës 8 Prill 1930 të Statistikës s'Ekonomis Kombëtare

—o—

Kryе I.

Norma të përgjithshme

Art. 1.

Në qarqet, Organet e zbatimit të Statistikës së Ekonomis Kombëtare si mbas nenit I, të ligjës 8 Prill 1930, janë Odat e Ekonomis në Prefekturа.

Në Prefekturat ku nuk ka Oda t'Ekonomis detyrën e kryen Prefektura nën drejtimin e Prefektit.

Art. 2.

Në Komunet regjistrimi bahet nën drejtimin personal të Kryetarit të Komunes, i cilli asht përgjegjës për rregullimin e mirëvajtjes së veprimeve relative.

Art. 3.

Kryetari i Komunes, i ndihmuë prej nji Komisioni të regjistrimit drejtuë nën Kryesin e tij, në të cilën marrin pjesë dy antarë të zgjedhun prej Këshillit Administrativ në mes të tyne, ose nga jashtë, dy antarë të zgjedhun prej Odës Ekonomis Prefekturës, ose prej asaj të Nënprefekturës në qoftë se janë në qarkun ku ndodhet Komuna, funksionarët e Shtetit, që drejtojnë në komunet sherbimet e mvaruna prej Ministriës s'Ekonomis Kombëtare dhe Sekretari i Komunes që foksionon edhe si sekretar i Komisionit.

Komisioni emnohet vit për vit me urdhër të Prefektit dhe për aplikimin të kësaj rregullore do të formohet, mbrënda 10 ditëvet, nga urdhëri i Ministrisë s'Ekonomis Kombëtare me të cilin ka me u caktuë dita e regjistrimit.

Komisioni bashkëpunon me Kryetarin e Komunes në të gjitha veprimet që i përkasin regjistrimit, në zgjedhjen e Nëpunsave të regjistrimit, në caktimin e mënyrave dhe instruksioneve, në shpërdarjen e mbledhjen e formularëve të regjistrimit, në kujdesimin që veprimet e regjistrimit të zhvillohen me rregull e të kryhen në kohen e caktueme dhe në vërtetimin e përmbledhjes s'informatave përkatëse.

Art. 4.

Kryepleqt e Katundeve, mbas urdhnave të Kryetarit të Komunes në rrethin e Katundit të tyne, kryejnë me radhë shërbimet mas nenit 2 të kësaj rregulloreje tue drejtuë e kqyrë veprimet e rregjistrimit të Katundit të tyne dhe tue qënë përgjegjës bashkërisht me Kryetarin e asaj Komune.

Art. 5.

Veprimet e regjistrimit i dorëzohen nëpunsit të regjistrimit i cili asht përgjegjës për rregullaritetin e veprimit të kryem prej tij.

Nëpunsat e regjistrimit emnohen prej Prefekturave mbrënda 15 (Pesëmbëdhet) ditve passi t'u jetë njoftue urdhëri Ministrial që cakton regjistrimin, dhe janë të zgjedhun, mbasi të jenë pëlqye prej Këshillit Administra-

tiv, midis nepunsavet të Komuneve, të Nenprefekturave, të Prefekturave, e ndër mësues e ndër të gjithë ata njerëz të cilët ndodhen në ndo nji sherbim ose tjetër dhe kanë njoftim mbi ekonomin e vëndit.

Nëpunsat e regjistrimit, për të kryemit e detyrës së tyne, do të kenë nji dishmi-njoftimi të leshuem prej Kryetarit të Komunes si dhe letër emnimin e Prefekturës ose Nënprefekturës për t'ja paraqitun kujtdo që t'a kërkojë.

Numuri i Nepunsavet të regjistrimit do të caktohet mbas nevojës të parapame për punën dhe si mbas largësisë së vendeve ku bahet regjistrimi.

Art. 6.

Rregjistrimi, do të fillojë e do të kryhet mbrënda kohës që ka me u caktue prej urdhrit Ministrial për veç zgjatimeve të afatit të bamë, mbi proponimin e Prefektit, prej Ministriës s'Ekonomis Kombtare.

Art. 7.

Rregjistrimi bahet me letër-pyetje të veçanta të dërgueme prej Ministriës s'Ekonomis Kombëtare por që mund të modifikohen mbas nevojës vjet për vjet prej asaj në të cilën rast i bashkanjiten dekretit ministerial që cakton regjistrimin.

Për shtypëshkrimin e përndarjen e këtyne modeleve në Prefektura kujdesohet Ministrija në fjalë.

Art. 8.

Formularët nuk duhet të kenë të fshime; ku ka nevojë për korigjime, këto do të bahen në mënyrë që të jenë të dukshme çifrat e fjalët e korigjueme e në këtë rast, në fund t'atyne formulareve, do të bahet shënimi i numrit të korigjimeve me deklarata të formuëm prej nëpunsit dhe dëftuësit.

Kryetarët e Komuneve së bashku me komisionet që Kryesojnë, kanë me u kujdesuë që formularët të mos kenë të metë as mos të dyfishohen dhe mbasi të kenë sqyrtue gabimet, kujdesen në bazë të gjithë elementave që kanë në dispozitë ose të bajnë të tjera vërtetime.

Art. 9.

Kushdo që nuk i jep informatat ose i jep të gabuëshme e të pa kompletushme, do të ndëshkohet në mënyrën e caktuem në ligjën 8 Prill 1930 në bazë të njoftimit të nëpunsit të regjistrimit, i cilli do të redaktojë nji verbal të veçantë e do t'ja transmetojë Kryetarit të Komunes.

Në rast ç'rregullimi, u takon Kryetarëve të Komuneve e Prefektave me ju riferue autoriteteve Gjyqësore fajtorët, të cilët do të ndëshkohen si mbas ligjës.

Art. 10.

Formularët do të jenë të nënëshkruem, prej dëftuësit, prej Nëpunsit të regjistrimit edhe prej Kryeplakut të Katundit e Kryetarit të Komunes, ose prej këtij të fundit, në qoftë se asht fjala vetëm për regjistrimin në qendren t'asaj Komune.

Si cili prej nënëshkruesëve merr për pjesën që i takon përgjegjësiën të rregullimit të rregjisrtimit.

Art. 11.

Odat e Ekonomis duhet të kujdesohen për nji përfundim të mirë të regjistrimit, me gjith mjetet që kanë në dispozitë, tue u dhanë instruksianet e nevojshme të dy antarëve të emnuem prej Komisionit Komunal të regjistrimit dhe tue vuë në dispozitë të Krye-

tarëve të Komuneve, ku t'a kërkojë nevoja, ndihmën e Këshilltarëve e të Sekretarit të Odave, tuj ba vezhgime në vënd, e tuej njoftue mbi këto Prefektat e Ministrin e Ekonomis Kombtare, për masat që duhen marrë.

Art. 12.

Nëpunsave të regjistrimit u takon pagimi i shpenzimeve për udhëtime, ashtu dhe nji dijet për kohen e kaluëme jashtë banimit.

Pagesa e shpenzimeve dhe e dijetës, bahet mbasi të paraqitet nji listë e perpillueme prej t'interesuemve dhe e konfirmueme prej Kryeplakut të Katundit dhe Kryetarit të Komunes, ose vetëm prej Kryetarit të Komunes në kjoftë se veprimi i nëpunsit të regjistrimit asht zhvillue në qendër të Komunes.

Art. 13.

Shpenzimet e bame për regjistrimin në të gjithë Prefekturat e Mbretnis së bashku me ato ku nuk ka Oda Ekonomie, kanë me u paguë prej nji fondit të përbashkët që do të gjendet në Ministrinë e Ekonomis Kombtare, të mbledhura prej buxheteve të gjithë Odave të Ekonomis, në mas të duhun dhe në përpjesëtim të sasiës së buxhetit të tyne.

Art. 14.

Mbasi të jenë krye veprimet prej nëpunsit të regjistrimit Kryetarët e Komuneve do të kujdesohen për mbledhjen e numrimin e të gjithë formularëve të cilat do vërtetohen nga ana e Komisionit për verifikimin e datave që përmbajnë përmbledhjet në për Prefekturat përkatëse, dhe mbasi të kenë ba kontrollimin ja dërgojnë formullarët Odës Ekonomis përkatëse që të kujdesohet si mbas instruksioneve që do të marin prej Ministriës Ekonomis Kombtare, për sqyrtimin dhe përmbledhjen e datave të qarkut të tyne.

Prefektura, ku nuk ka Oda Ekonomie, ka me u kujdesuë vet për këto veprime, veç se kur Ministrija e Ekonomis Kombtare do të disponojë ndryshe.

Art. 15.

Mbasi të jetë ba kontrollimi, sqyrtimi e përmbledhja, Odat e Ekonomis ose Prefekturat i a dërgojnë përfundimin Ministriës, e cila kujdeset për kompilimin e Statistikës se përgjithëshme për gjithë Mbretninë, tuej disponue si mbas rastit kontrolime e inspektime, për me verifikue regullimin e veprimit të bamë prej organeve të regjistrrimit.

K r y e II.

Dispozita të veçanta për regjistrime të ndryshme

a) Rregjistrimi Bulqësuer

Art. 16.

Rregjistrimi Bulqësuer përfshin: 1) Rregjistrimin e Shtëpive Bulqësore përgjithësisht. 2) Rregjistrimin e gjasë së gjallë.

Ajo do të përbahet në bazë të dy modeleve të veçanta.

Art. 17.

Rregjistrimi i shtëpive Bulqësore, përfshin të gjitha shtëpit të zotnueme prej privatëve dhe prej Instituteve të ndryshme që kan tokë për prodhim bulqësuer e pylluer, cilado të jetë gjanësija e tyne, edhe në qoftë se prodhimet e xjeruna prej tyne nuk shiten në treg.

DRAFT

Përjashtohen vetëm kopshtet e vegjël e bagçet rreth shtëpive të qendrës së Komunes e të kryevëndit të Prefekturës e Nënprefekturës.

Rregjistrimi Bulqesuer, ka për qëllim me njoftuë sasiën e tokave e mënyrën e shfrytzimit, dasiën e tyne, personalin që kujdeset për këto, gjëndjen e tyne në ujitje, industrinat bulqësore, maqinat ose ndërtesat të përdoruna dhe forcën motrice të tyne, sasijën e llojin e prodhimevet të nxjerruna në vitin bulqësuer et. et. Informatat për regjistrimin e shtëpive bulqësore kanë me u dhanë me formullarë të veçantë prej drejtoris së shtëpis, ose prej kryetarit t'administratës nga i cilli mvaren shtepit e ndryshme, ose prej ati që i përfaqëson.

Konsiderohet drejtuës, për sa i përket regjistrimit, ajy që administron drejt për së drejti tokën me risk të vet; në rast se fitimet u takojnë shumë njerësve, njiset si dhrejtuës, ay që banon në tokën që punon dhe e drejton.

Art. 18.

Regjistrimi i kafshëve, përfshin kualtë, gomarët, mushkat, qelë, buejt, delet, dhitë, thiet, shpezat shtëpiake, bletat, krymbat e mëndafshit etj.

Janë të përjashtuem prej regjistrimit vetëm shtazat shtëpiake (pulat) lepurat të butë shtëpiakë, prodhimet e të cilave nuk shiten në treg, dhe që gjenden në qendër të Komunevet, të Kryevendeve, të Prefekturave ose Nënprefekturave.

Shtazat që përfshin regjistrimi, duhet të numrohen në vënd, ku gjenden në kohën e prehjes edhe në qoftë se gjenden jashtë Komunes ku qendrojnë; por mbasi nuk bahet në nji kohë regjistrimi i të gjithë bagëtive, qi gjenden në Mbretnië, nëpunsat e regjistrimit duhet të marin shënim me kujdes në bazë të deftimeve të pronarëve, ose zotnuesve të bagtive, që gjenden në Mbretnië. Nëpunsat e regjistrimit duhet të marin shënim me kujdes në bazë të deftimeve të pronarëve, ose zotnuesve të bagtive, që për çfaret arësye janë largue prej vëndit të qëndrimit, në mënyrë që të bahet i mundshëm dhe i volitshëm identifikimi i tyne, atje ku gjenden efektivisht, në kohë të regjistrimit, tue kujdesue që të mos ngelen jashta regjistrimit ose mos të regjistrohen dy a shumë herë. Do të regjistrohet gjith ashtu edhe gjaja e gjallë, që ndër disa muej të vitit, asht dergue për me kullot jashta.

Kualt e mushkat e oficierave ose të Ushtërisë Kombtare, kanë me u regjistrue mbas kujdesjes t'autoriteteve eprore të ushtëris të gjith se cilitnë vënd, ose prej Drejtorit të Depove rritjeje, ashtu edhe kuajt hamshor të Qeverisë, e të gjitha shtazat e ç'farë do lloji qi gjenden pranë instituteve, kanë me u regjistrue mbas kujdesjes së drejtuësave të tyne, dhe shënimet që i përkasin gjasë së gjallë, bahet në nji formular të veçantë.

Art. 19.

Në qoftë se gjaja e gjallë mvaret prej shtëpisë bulqësore që e përfshin regjistrimi bulqësuer do të shënohet si në formularin e bagtis, ashtu edhe a'atë të shtëpive bulqësore me shënim reciprok ndër dy modelet.

b) Rregjistrimi Industrial e Tregtar

Art. 20.

Rregjistrimi Industrial e Tregta përfshin Shoqnit Industriale, ushtrimet tregtare e të zejtarëve të institute bankare, të shtëpive të transportimit e ç'do lloj tjetër aktiviteti me karakter ekonomik.

Duhet, pra të regjistrohen puntoriët, laboratoret e Kantjeret, dyqanet, shtëpiat tregtare, edhe ushtrimet industriale që tash për tash janë vendue në banime fikse ose janë në forma shëtitëse.

Përfshihen edhe ato ushtrime që e kanë më të paktin karakter tregëtar e industrial, si farmaciat, ushtrimet të frizoreve e të rruësvet.

Nuk përfshihen sypërmarjet bulqësore, pyllore, e të bagtive, të cilat hyjnë në regjistrimin bulqësuer e pyllor, por përfshihen në këtë regjistritrim disa forma t'aktivitetit të lidhuna me bulqësi dhe pyjet, si koncesionet industriale të duhanit, kur flitet për ushtrime që meren ekslusivisht me prodhimin e duhaneve të prodhue prej të trelëve; sipërmarjet për të premunit e pyjevet për prodhimin e landës; stanet e djathit, kotecet e pulave, krymbat e mëndafshit, bletët etj, kur të jenë të ndërtue me cilësi industriale e tregëtare. Sharat ose tjera stabilimente industriale që janë të ndryshme ndër pyje etj. Në rast që të çfaqen dyshime mbi përfshimin e regjistrimit të shtëpive bulqësore që kanë dukje industriale e tregëtare, do të përjashtohen nga regjistrimi industrial e tregëtar, e do të regjistrohen n'atë të bulqësisë ato ushtrime që përvendojnë një prodhim të punimeve bulqësore të tokës më të madhe së gjysma e punimit komplesiv.

Duhet të shënohen në regjistrimin industrial e tregëtar ushtrimet e peshkut të çfarë do llojet e me çfarë do mjetit që të bahen; përfaqësuësit tregëtar, zyrat e këmbimit të hollash, të sigurimit ose të ndo një firmës tjetër t'aktivitetit tregëtar, komisionarët etj. që për zakon ushtëroinë këtë profesion; laboratorët pranë shkollave profesionale, ku punonin refugjatët politik ose të burgosurit.

Nuk i përfshin regjistrimi profesionet e lira, përveç rastit kur këto t'ushtroinë aktivitetin e tyne, me karakter tregtar e industrial, si për shëmbëll shtëpit e shërimit, edhe kur drejtimi ju asht besue mjekëve etj. Nuk i përfshin regjistrimi punimet që bahen ndë shtëpia, për llogari të industrialeve dhe tregëtarëve, si ato që bëhen në shtëpi, mbas porosis të tjerëve, që ushtroinë industrinë e tregëtinë, si me thanë bamjen e këmishave, tue qënë që njerëzit që kryejnë këtë soj pune njihen në numërin të personalit të ushtrimit për të cilin ata punojnë.

Kurse këta në shtëpi të vet ushtrojnë një industrië ose tregëtië drejt për drejt për publikun, kështu që banimi i tyne funksionon si dyqan, industria ose tregëtia kështu e ushtrueme përfshihet prej regjistrimit.

Këto janë punët që bëhen në shtëpia prej punëtorëve ose tregëtarëve e industrive të vogëla që kanë një klientell të tyne direkte, roba qepës, këpuctar, zdrukthëtar, farkëtar etj.

Përfshihen në regjistrimin hotelet, gjellëtoret, kafet, pensionet dhe ata

që japin oda me qira, kur këto mbas dukjes e stoliës, janë si hotele. Gjith ashtu hyinë në regjistrim sipërmarësit teatror, qinomatografet, fabrikat e industrinat e transportimit për tokë për uji e air, fabrikat e duhanit, stabilimentat e banjave e të ujnave shëndetësore pastërtit e petkave, sipërmarjet e dlirësis së publikut e të mbartjes të ndytsinave të rrugave, ose të shtëpiave, pazaret e kasaphanet etj., dhe në kjofshin prej ndo nji entit publik.

Art. 21.

Dyqanet e mbyllun në kohen e regjistrimit, nuk i përfshin regjistrimi por nëpunsat e regjistrimit do të mbajnë shënim për këto: tuej përpillue formularin e tuej shënue vetëm emnin, adresën e llojën e shtëpis, me shënim të mbylljes nga shkaku i shtinës, me gjith ato shënime që i shofin të dobishme.

Dyqanet që nuk punoinë, por janë të hapët dhe ata që janë tuë u mbyll në kohën e regjistrimit, janë të përfshi në regjistrim.

Art. 22.

Përgjith sejcillin ushtrim industrial ose tregtar, do të përpillohet nji formular i dalluëm nga ushtrimet e tjera t'asaj shtëpie, edhe sikur të ndodhen në atë Komune.

Për gjithë sejcillin ushtrim industrial ose tregtar, nga ana tjetër do të përpilohet nji formular i vetëm, sicilli do që të jetë numri i artikujve që janë objekt i prodhimit ose i tregtiës.

Në rast tregtoresh të ndryshme t'ushtrueme në nji lokal prej të zotëve të ndryshëm ashtu edhe në rast të formës të ndryshme të aktivitetit t'ushtruëm në stabilimenta ose lokale të bashkuëme e të zotnueme prej asaj shtëpije, do të përpilohen aq formular sa janë shtëpit e format e aktivitetit të tyne.

Në rast se Drejtorit janë të veçanta nga stabilimentat, ose shtëpit që disponoinë prej tyne e të ngrehuna në Komune të ndryshme nga ato ku gjenden këto stabilimente ose shtëpija, do të përpillohen formulare të ndryshëm për Drejtorit ose për Stabilimentat e shtëpit.

Në rast që Drejtorija gjëndet në atò Komune ku janë stabilimentat tregtare që mvaren prej saj, ato do të regjistrohen në nji formular të përpiluëm për nji stabiliment ose për nji shtëpie.

Për shtëpit Bankare ose të transportimeve maritime, ajrore etj., gjithë se cila zyrë e mvarun, ose kantier, ose axhensi e tyne, formon objekt të veçant e do të përpillohet në nji formular të veçant.

Art. 23.

Regjistrimi industrial e tregtar ka për qëllim me ba të njoftun numrin e dyqaneve, karakteristikat e përgjithshme të tyne, natyrën e llojin e aktivitetit të tyne, numrin, llojën, moshën, nënështetësiën të njersve e punimin e tyne, nevojën për nëpunsa teknik e për puntor të specializuem, forcat motrice e mënyrat e transportimit që përdoren prej tyne; prodhimi e shitja vjetore; tregjet e shitjes ose burimi i mallnave të prodhuem e të shitun; vështirsit që pengoinë zhvillimin e shtëpiëve (Tagret doganore, mënyrat e transportimit, e të komunikasioneve, konkurenca puntorije) etj.

Art. 24.

Informatat për regjistrimin e shtëpieve industriale e tregtare të zejtarëve do të nepen me nji formular prej të zot, ose prej drejtuësit të tregtive, ose prej atij që e përfaqëson.

DISPOZITA TË FUNDIT

Art. 25.

Për veprimet e përmbushjes të regjistrimit bulqësuer industrial ose tregtar, për sa kjo rregullore nuk çakton dispozita të veçanta do të aplikohen analogjisht ato dispozita e instruksione të adoptueme për regjistrimin të popullsiës, por mos të jenë në kundreshtim me dispozitat që përmban kjo rregullore.

Kështu edhe Komunet kanë me marrë parasysh përfundimet e regjistrimit të popullsisë e të eksperiencës së fituëme nga ajo; për me drejtue, kompletue e kontrolluë veprimet dhe përfundimet e regjistrimit industrial e tregtar, Ministrija e Ekonomis Kombtare, mund të dërgojë dhe të tjera instruksione që kanë me ju duk të nevojshme për mirëvajtjen e regjistrimit në fjalë.

Art. 26.

Informatat e mbledhuna në regjistrim do të ruhen në mbështetësië të posaçme prej zyrtareve e mund të njoftohen vetëm në formë kolektive. për vënd, për natyrë e për lloj.

Asht pra e ndalueme për nupunsat e regjistrimit e për gjith ata që marrin pjesë në veprimin të regjistrimit në fjalë me dhanë informata dhe numra që i përkasin vetëm një shtëpije.

Art. 27.

Kjo rregullore hyn në fuqië ditën që të jetë botue në Fletoren Zyrtare të Mbretnis, e për zbatimin e saj asht ngarkuë Këshilli Ministruer.

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. të Jashtme:
Pandeli Evangjeli d. v.

Ministri i Drejtësis:
V. Avrami d. v.

Ministri P. Mbrendshme:
Musa Juka d. v.

Ministri Arsimit:
H. Mosi d. v.

Ministri Financavet:
K. Thaçi d. v.

Ministri Ekonomis Kombëtare:
Mehdi Frashëri d. v.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 2238/II D. 4-XII-1930 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me d. 2-XII-1930,

D e k r e t o n

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores mbi zbatimin e Ligjes së Statistikës.

Tiranë, me 15 Dhetuer 1930.

Z O G d. v.

BKSH

Ministrija e Ekonomis Kombëtare

Regjistrimi i Përgjithshëm i shtëpive bulqësore

të vitit 1931

1) Prefektura? ..... N. prefektura? ..... Komuna? .....
Katundi? ..... Vendi? .....

2) Numri rënduer progresiv i fomullarit (për Komune)? .....

3) Emni i shtëpis dhe hektaret? .....

.....

4) Natyra e shtëpis (përgjithsisht bulqësore d. m. th. shum punime; ose: kopësht bahçe, vënesht, pemërishte, ullishte, pyll etj.)? .....

.....

5) Qendra e shtëpis (d. m. th. shtëpija e bulkut, grazhdi, dhe vathi etj., është pran shtëpis ose të katundit, ose në fushën e hapët? .....

.....

6) Cilsinat të pronarit dhe të bashkëpronarit (Shteti, Komuna, një Shoqni fetare ose tjetër, një person ose shum persona. Të tregohet emni mbiemni, banimi, edhe në qoftë se pronari ose bashkëpronarët janë bulq apo jo)? .....

.....

7) Në është fjala për një shtëpi të pamvarun ose një shtëpi qe mvaret, bashk me të tjera, prej një administrate qendrore, ose është fjala për një administrat qen-drore? (Të tregohen cilsinat dhe banimi i Drejtorit ose i administratorit qendruer.)? .....

.....

8) Në qoftë se drejtuësi nuk është as pronar i shtëpis, të tregohen cilsinat e tija dhe numri i familjes së tij? .....

.....

9) Drejtori e ka marë tokën drejt për drejt nga pronari apo nga një ndërmjetës (qiramarës)? .....
Qysh është forma e kontratës (bulqësi e mesme, apo qira e vogël,) në natyrë (me pjesë) dhe konditat kryësore të tyne.? .....

.....

BKSH

10) Sipërfaqja e shtëpis dhe ndarja e sajë: .....

a) Tokat e mjelluna të veçanta? .....

b) Tokat e mbjelluna me bima druni? .....

SH. Për tokat e mbjelluna, kuptohen tokat e punueme dhe tokat e tjera të livrueme dhe të mbjelluna për bima barishte, si lëndinat e bamuna, kopshtet dhe kullotjet qe ndryshohen në periudhën jo ma e madhe se dhet (10) vjet. .....

Për toka të mbjelluna veçanërisht, kuptohen ato që kan ma shum pem. .....

Për toka të mbjelluna me bima druni, kuptohen ato që punohen bashkërisht me bima barishtje dhe druni, veç se mos të jenë vëneshta, pemërishte dhe si këto, qe janë të punueme me vija .....

c) Toka të mbjelluna me druna të specializue, (ullishte, vëneshta, portakale, bajame, pemurina, mana, kallama e të tjera)? .....

ç) Lëndina të përhershme (të njishme.)? .....
(me bima druni.)? .....

SH. Për lëndina të përhershme kuptohen tokat qe janë destinue ekskluzivisht, për prodhimin e barit, për një kohë ma shum se 10 vjet, edhe bari i së cillës përgjithsisht korret.

d) Lëndina kullotje të përhershme (të njishme)? .....
(me bima druni)? .....

SH. Për lëndina kullotje të përhershme kuptohen tokat e destinueme eksluzivisht, për prodhimin e barit, për një kohë ma shum se 10 vjet, bari i së cillës, i korrun në Prendverë, dhe pastaj mbetet si kullotje në gjith vitin.

e) Kullotje të përhershme (të njishme)? .....
(me bima druni)? .....

SH. Për kullotje të përhershme kuptohen toka të destinueme eksluzivisht, për prodhimin e barit, ma shum se 10 vjet, edhe bari i së cillës përdoret eksklsivisht për kafshët qe kullosin.

f) Pyjet? .....

SH. Për pyje kuptohen toka të mbjelluna me druj pylli, ma shum se gjysma e sipërfaqes së tyne, dhe në qoftë se kullotet bagtija.

g) Toka të papunueme qe prodhojnë? .....

SH. Për toka të papunueme, qe prodhojnë, kuptohen toka të reja, qe japin një prodhim në dru ose në bar.

i) Toka të paprodhueshme? .....

SH. Për toka të paprodhueshme, kuptohen toka të mbulueme me uji, me ndërtime (si oborret e të tjera) rruga dhe toka që janë krejt shterpa qe nuk japin prodhim bulqësuer.

Sipërfaqja e përgjithshme .....

11) Regjimi i ujinave :

a) Toka gjindet në kondita të mira për rrjedhjen e ujnavet, apo lypë përmirësim për këtë qëllim? .....

.....

b) Është toka bregore apo fushë? .....

.....

c) Janë toka të vadituna; të tregohet përpjestimi, në barazim me sipërfaqjen e përgjithëshme të shtëpis? .....

ç) Vaditja ësht e rregullëshme, apo e përkohëshme? .....

d) Ujt për vaditje merret aty nga lumejt, nga liqene, kanale, burime puse, apo puse arteziane, depozita artifiçiale? .....

.....

e) Meret në marveshtje me të tjera Shoqnina? .....

.....

f) Ujt për vaditje është i lejushëm për gjith vitin, apo vetëm në disa muj, edhe në cillët? .....

.....

12) Bagtija? .....

.....

SH. Në qoftë se shtëpija ka bagti, prej çdo far lloj, duhet kompillue pyeja e modelit 1 *b.*, tue tregue këtu numrin dhe reciprokisht, të tregohet në modelin 1 *b.*, numri i këtij formullari .....

.....

13) Gjenden në shtëpi plehnishte, ose mullar për rujtjen e barit, dekovil, filovi, miniere, gurore etj.? .....

.....

14) Gjenden në shtëpi motora, makina, janë këto të pronarit, të shtëpis, apo të marruna me qira? .....

.....

SH. Të tregohet cilsija dhe numri i motorave mekanik, të përdoruna, si dhe forca e tyne në H. P. (P. Sh. motorat me erë, rrota me uji, turbina prej uji, makina, me vapore, motora me gaz, motora me voj të rënd, motora me benzin e të tjer, motora elektriku, dinamo, korente elektrik, konduktorët, automobila, motocikleta e të tjera).

SH. Të tregohet cilsija dhe numri i makinave bulqësore (parmënda hekuri me fuqi kafshe, me një ose ma shum presje; parmënda hekuri me fuqi mekanike, parmënda me diska, të tjera parmënda, zvara me diska, ruol, estirpator,

BKSH

prashitës, maqina për mbjellje, shate, edhe shate mekanike, maqina për të shirë, për të lidhur, për të korrur, për të këthye barin, për të përhapun, për të shi grurin, orizin, dhe farnat; shkoqitje për misër me dorë, ose me motor, për të zveshur misrin, për të qirue, për të shoshun, dhe për të situr farnat, për të shtypun me dorë, ose me motor; instalime telefonike, motopompa, edhe mobila etj.

15) Punime qe bahen në vitin bulqësur

P u n i m e	Sipërfaqja e punueme në Hek.	Prodhimi qe është marrë në vazhdim të vitit, në kuintal
a) Drithna ? (grun dimni dhe grun prendvere, tersban, thekën, elb, oriz, misër, mel, etj.)		
a) Barishte ? (bathë, fasule, bizele, thjerr, qiqra, e të tjera.		
c) Kokrra ose rrajë qi hahen ose për kullotje ? (patate, kokra me rrajë, si rika panxhare e të tjera.)		
ç) Bima industriale ? (panxhar sheqeri, kanap, lin, duban, susam, recin, pamuk, e të tjera.)		
d) Bima bari ? (tërfil, llucernë, lupin, sulla e të tjera, ose bar të trazuar.)		
e) Barishte ië freskta ? (pipa, artishok, lakra, lakrame, qep, udhra, bath, fasule, bizele, domate, sedan, pjepra, tranguj, etj.)		
f) Bima të vogla me perime ? (fraulla, boronice, etj.)		
g) Hardhija (numri i bimave) ?		
h) Ullisht e numri i bimave) ?		
i) Perime të thata ? (portokale, mandarina, limone etj.)		

BKSH

Punime	Sipërfaqja e puuueme në Hek.	Prodhimi qe është mar në vazhdim të vitit në kuintal
c) Perime (numri i druve)? (zerdeli, qershi, fiq, bajama, molla, arra, dardha, pjeshka, kumbulla etj.)		
mj) Punime të bashkueme? (bostane, kavol, dhe perime të tjera.)		
n) Pyje?		
1) Pyje të përhershëm qe priten .		
2) Me druna të gjata		
3) Pyje të bashkueme		
SH. Të tregohet, sa është e mundur, sasija e drunit qe përdoret si djegse, ose shitet. Të tregohet, sa është e mundur, sasija e prodhimevet (gështënja, koçimare, gjind, lëkur, reshin, etj.) që merren, që me një Korrik deri me 30 Qershuer të vitit tjetër.		

16) Indusrinat e katundit

Cilat prodhime të shtëpis ndryshohen nga drejtuësi, në vazhdim të vitit, (tëlyn, djath, veu, voj etj.)? .....

.....

Cila ka qenë sasija e prodhimit qe ësht ba në shtëpi (rrusb, ulli, qumështt,) dhe cilsinat e prodhimeve, veçanërisht për çdo punim (tëlyn, djath, voj, ulli, ven, stafidhe etj.)? .....

.....

17) Personali

Të tregohet numri, lloji, nënshtetsija, të personave qe gjinden në shtëpi, tuj specifikue, në janë persona të familjes të Drejtorit, a janë nëpunsa teknik, ose t'administratës, ose puntor të specializuem, ose tjetër personal me rrog? .....

.....

.....

.....

BKSH

Vrejtje. — Njoftimet e këti formullari nuk duhet të botohen, por duhen të mbahen të mëshefta, për çdo komune. Personali i ngarkuem për të mar këto njoftime, duhet të jetë shum i mësheft. Përhapjet e tyne dënohen në bazë të Kodit Penal.

Njoftimet qi kërkohen, kan për qëllim të tregojnë shtëpin bulqësore, dhe konditat të bulqësis Shqiptare.

Tuj i gjegjun ekzakt, në gjith pytjet, jo vetëm që bahet detyra e një nënshtetasi, por ndihmon si bulqit dhe Qeverin, për të studiue mjetet, dhe të merren masat e nevojshme, për përparimin e konditave të bulqësis, dhe të gjith Ekonomis Kombëtare.

Prandaj ata që japin deklarata të rrena, ose të meta, dhe nuk duen të gjegjen në këtë formullar, dënohen, në bazë të Ligjës 8 Prill 1930 mbi Statistikën Ekonomike.

———o———

Deklaroj se gjegja që mban ky formullar është e vërtet.

Nënshkrimi i Drejtorit të shtëpis
ose të përfaqësuesit

.....

I mbushun më.....

Nëpunsi i regjistrimit .....

U-pa
Kryetari i katundit

.....

U-pa
Kryetari i Komunes

.....

BKSH

Ministrija e Ekonomis Kombëtare

Regjistrimi i Përgjithshëm i Bagtis

të vitit 1931

1) *Prefektura?*..... *N.-prefektura?*..... *Komune?*.....
Katundi?..... *Vëndi?*.....

2) *Numri rënduer progressiv i formularit (për Komune)?*.....

3) *Numri i formullarit korespondent i regjistrimit të shtëpis bulqësore, kujt i përket bagtija?*.....

4) *Natyra e shtëpis për (bagti në kullotje, rritjë bujsh, kual, dhen, dhi, thi, pula, lepura etj., vënde për hamshor, vënde për mësime dhe për prova, vënde industriale, tregtare, transporti, grazhde e tjera)?*.....
.....

5) *Emni mbiemni, drejtimi i pronarit të shtëpis, ose të përfaqsuesit?*.....
.....

6) *Mbiemni, banimi i drejtuesit, në ësht tjatër se pronarit?*.....
.....

7) *Forma e kontratës midis pronarit dhe drejtuesit mbi bagti (në qoft së ësht fjala për koloni apo bujk, d. m. th. në ësht dhën uha bagtija)?*.....
.....

8) *Gjendja e bagtis në datën e regjistrimit?*.....
.....

a) **Kual**
- *1) mëza nën tri vjeç* . . . . . .
- *2) kual ma shum se tri vjeç*
  - a) *hamshor* . . .
  - b) *për pun* . . .
  - c) *për prodh* . .
  - d) *femna për pun* .
  - *Shuma*

b) **Gomar**
- *1) mashkuj për prodh dhe për pun* . . . . .
- *2) femna për prodh, dhe për pun* . . . . .
- *Shuma*

BKSH

c) Mushka
1) *mashkuj dhe femna nën dy vjeç* . . . . . .
2) „ „ „ *mbi dy vjeç* . . . . . .
Shuma .....

ç) Buaj . .
1) *mashkuj (çdo moshe)* . . . . . .
2) *femna (çdo moshe)* . . . . . .
Shuma .....

d) Qé . .
1) *mashkuj (viça nën një vit, dema nga një deri dy vjeç, dhe mbi dy vjeç)?* . . . . . .
2) *mashkuj të tredhun?* . . . . . .
3) *femna (viçoke nën një vit dhe lop qumështore, qumsht i se cillës shitet ose punohet)?* . .
4) *Çdo lloj lop?* . . . . . .
Shuma .....

Prodhimi Hektol.

Sasija e qumshtit qe prodhohet në një vit, tuj përjashtue ajo që jepet viçokave . . . . . .
Sasija e qumshtit i prodhuem për një lopë, në një vit . . . .
Shuma .....

Kilogram

Prodhimet e stanit që jep në vit, për gjith qumshtin qi jep shtëpija . . . . . .

Tëlyn . . . . . *Kg.* .....
Djath . . . . . „ .....

Kg. **Numri**

Sasija e bagtis qeve të përdorun për pun . . . .
Lopa . . . .
Qé . . . .
e) Thij (Derra) (çfardo lloj)
f) Dhen
1) *shqerra nën një vit* . . . .
lesh të marun mesatar për çdo qijngj. . . . . .
2) *desh mbi një vit të tredhura, apo jo* . . . . .
leshi që meret për çdo dash . . . .
3) *femna mbi një vit* . . . .
leshi që meret mesatarisht nga çdo dele . . . .
Shuma .....

BKSH

	Kg.	Numri
Qumshti i prodhuem në vit, veç atij qe i jepet shqerravet ..... *Hektol.*		
Djathi që prodhohet në një vit, Kg.		
4) të tredhuna.	.....	.....
Shuma e dhenve	.....	.....
g) dhi — *1) kedha nën një vit*	.....	.....
2) mashkuj ma shum se një vit	.....	.....
3) femna ma shum se një vit.	.....	.....
Sasija e qumshtit që është prodhue mesatare, nga çdo dhi në vit, Hektol.	.....	.....
Sasija e djathit prodhue në një vit Kg.	.....	.....
Shuma e dhive	.....	.....
h) Pula prej çdo race — *1) zogj*	.....	
2) pula.	.....	
Sasija e veve prodhue në çdo vit?	.....	
3) gjela?	.....	
4) gjela të tredhun?	.....	
j) Pata — *1) biba?*	.....	
2) pata?	.....	
l) *Rosa?*	.....	
m) *Gjela deti?*	.....	
n) *Pëllumba (Çift)?*	.....	
o) *Lepura?*	.....	
p) *Blet?*	.....	
Zgjoj?	.....	
Mjalt?	.....	
Dyll?	.....	
s) Krymba mëndafshi?.	.....	
1) Far mëndafshi qe është ngref në vit . . Kg.?	.....	
2) Shika të njoma qe mledh në vit . . . „	.....	
q) *bagti qe dërgohen në kullotje jasht shtëpis?*	.....	
(cillsija e bagtis, numri, komuna ku është dërgue me u kullot)?	.....	
	.....	
r) *Bagtija qe është dërgue për shitje, për therje, etj. Numri?*	.....	

BKSH

SHËNIME: — Njoftimet qe përmban ky formullar, nuk duhen të botohen për as një shkak, veç se kuer të mlidhen me Komunet e tjera. Personat, që do të zbatoin rregjistrimin, duhen të mbajnë ma të madhen mësheftësi.

Mos kujdësjet dënohen si mbas Kodit Penal.

Ata qe bëjnë deklarata të rrena, ose nuk duen të japin lajmë të kërkueme në ket formullar, dënohen, në bazë të ligjes 8 Prill 1930 mbi Statistikën Ekonomike.

Nënshkrimi i Pronarit,
ose Drejtori të shtëpis, ose të Përfaqsuesit:

.....

I mbushun më.....

Nëpunsi i regjistrimit:.....

U-pa
Kryetari i Katundit:.....

U-pa

Kryetari i Komunes:

.....

BKSH

Ministrija e Ekonomis Kombëtare

Regjistrimi i përgjithshëm i shtëpive industriale dhe tregtare

të vitit 1931

1) Prefektura?..... N.-prefektura?..... Komune?.....
Katundi?..... Vendi?.....

2) Numri rënduer i formullarit (për Komune)?.....

3) Emni, lloji, banimi, nënshtetsija e shtëpis tregtare?.....
.....

Të tregohet shtëpija tregtare është individuale, kolektive me komandit, ose me garanci të limitueme (të kufizueme), me aksione, kooperative, një zyr publike (Shteti, Komune etj.) .....

4) Emni, mbiemni, nënshtetsija, banimi i pronarit të ushtrimit, ose i personit që e përfaqëson, ose nënshtetsija e personavet që formojnë Shoqnin? .....
.....

5) Kapitali shoqnuer dhe i derdhun, tuj veçue kapitalin kombëtar, nga aj i huej, dhe tuj tregue kombësin e tij?.....
.....

6) Lloji i industris, i tregtis ose i punimeve të tjera, tuj tregue në se punimi përmban tregti dhe industri? .....
.....

7) Tregtija me të madhe, ose me të vogël, ose me të dyja?.....
.....

8) Fuqija prodhuese dhe shitjet? (prodhimet kryesore të fabrikueme ose të tregueme për çdo vit, tregjet ku shiten, të vendit, ose të jashtmet, lënda e prer qe është përdorue, nevoja e tyne e përvjetshme, burimi i tyne qe brenda, ose jasht, vleftja e tyne tuj tregue sasin e tagrin doganuer, dhe shpenzimet e tjera për prurjen së jashtimit)?.....
.....

9) Industrija dhe tregtija, në bahen me shëtitës?.....
.....

BKSH

10) Shoqnija ka një dyqan vetëm, ose ma shum? .....

Në rastin e dyt, kush është dyqani kryesuer, dhe drejtimi qendruer, dhe cilat jan degat e saja, dhe ku gjinden? .....

.....

11) Veprimi i dyqanit për gjith vitin? .....

Në ç' koh, dhe për sa koh mund të ndalohet? .....

.....

12) Personali qe punon në shtëpi, në datën e regjistrimit, tuj përmbledh personalin qe përdoret jashta shtëpis, për nevojat të funksionimit të veprimit të përkohshëm.

	Mashkuj të vëndit	të huej	Femna të vëndit	të huej	SHUMA
a) Pronarët, bashkëpronarët, Drejtuesat?					
b) Personali dirizhues (drejtor, teknik, administrator, ose prokurator)? . . .					
c) Personal i administratës (llogaritar, agent, daktilograf)?					
ç) Personal teknik (Ingjiner, etjer.)?.					
d) Personal i tregtis, për shitje të vogla?					
e) Kryepuntuer, puntuer, kallfa, bartës, personal punësh të rënda?.					
ma posht se 15 vjet . .					
nga 15 deri 18 „ . .					
nga 18 e lart					
f) Personal që punon ne shtëpi, për llogari të Shoqnis?					
SHUMA					

BASH

13) Pengime qe çfaqen në zhvillim të shtëpis (tagra doganore, taksa të tejra, mjete komunikimi dhe transporti, puntuer të specializuem, konkurenc etjera)? .....

.....

14) Mjete të transportit që ka Shoqnija?

a) të tokës (kafsh, maqina, lokomotiva, traktor etj.), me motor të vegjël (automobila, autobus, autokar, motocikleta)? .....

b) me udha të ujt (barka me kupij, kaik, barka me vapor, kaik me benzin, kaik me vela)? .....

c) me udh të ajrit (aeroplan)? .....

15) Fuqija e motorave qe përdoren në shtëpi, tuj treguë në prodhohet me fabrika, ose blehet prej të tjerve? .....

16) Kazane me avull?

a) të nguluna (për veprimin e motorave me avull numer ..... për ngrofjen të dhomave të industris, për të tjera përdorime industriale)? .....

.....

b) gjysëm të nguluna? .....

c) llokomobile? .....

17) Konsumi i vjetshëm i ndezëses?

Thëngjill mineral	kuintal	.....
Lignit.	„	.....
Koks	„	.....
Dru në vandak (dëng). . . .	„	.....
Thingjill druni	„	.....
Të tjera djegëse.	„	.....
	Shuma kuintal	.....
Nafta dhe vojna të rënda . . .	kuintal	.....
Vojguri dhe vojna të mesme . .	„	.....
Benzin dhe ndezëse të lehta . .	„	.....
	Shuma kuintal	.....
Gaz ndritës m^3 (metro kubik) . . .		.....

—o—

ARJ 153
KONTROLLI 1974-1978

SHËNIM: Lajmet që përmban ky formullar, nuk duhen të njoftohen, ose të botonhen për asnji arsye, veç se të mbledhuna ndër Komunet e tjera.

Pra personat qe do të zbatojn regjistrimin, duhet të mbajn ma të madhen mësheftësi.

Mos kujdesjet do të dënohen në baz të Kodit Penal.

Ata qe bajn deklarata të gabueme, ose nuk duen të japin lajmet e kërkueme, në këtë formullar, do të dënohen, në bazë të ligjes 8 Prill 1930, mbi Statistikën Ekonomike.

———o———

Deklaroj se gjegjet që jan dhën në këtë formullar, jan të vërteta.

Nënshkrim i pronarit, i Kryetarit,
ose i Drejtuesit të shtëpis, ose kush e përfaqëson

.....

I mbushun më .....

Nëpunsi i regjistrimit .....

U-pa

Kryetari i Katundit .....

V 97.98

U-pa

Kryetari i Komunes

.....

V 1989

BKSH

BKSH

BKSH